

ZUXION

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



KUJDES

ZUXION është insekticid sistemik dhe translaminar me veprim kontakti dhe të brendshëm. Acetamiprid është një insekticid neonicotinoid që vepron në sistemin nervor duke shkaktuar paralize. Është insekticid efektiv në kontrollin e disa insekteve me aparat gojor shpues thithës (afidet, aleuroidet, cikadat, tripset) dhe aparat gojor brerës (Lepidopterët dhe Koleopterët).

Përmbajtja: Acetamiprid 20% (200 g/kg).

Formulimi: Granula të tretshme (SG).

Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni në vende të sigurta dhe të paarritshme nga fëmijet.
- P402+P404: Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- P280: Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Evitoni kontaktet e syve dhe të lekures me preparatin.
- Evitoni thithjen e avujve të preparatit me organet e frymemarrjes gjatë përgatitjes së solucionit sperkates dhe gjatë sperkatjes.
- P270: Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- P264: Lani duart menjëherë pas përdorimit.
- Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet sperkatese.
- EUH401: Të evitohen rreziqet e shëndetit të njeriut dhe ambientit, në përpunueshmëri me instruksionet për përdorim.
- P273: Shmangni hedhjen në mjedis. Beni shkatërrimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

Udhëzim për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast gjellitje ose marrje me organet e frymemarrjes, pacienti vendoset në një vend me ajër të pastër dhe të freskët dhe mbulohet për tu mbajtur ngrohtë.
- Provokohet vjellje (me përjashtim të rasteve kur pacienti ka humbur ndergjegjen), duke i dhënë pacientit një gotë me ujë, në të cilën është tretur me parë një luge gjelle kripe.
- Në rast kontakti me lekuren apo sytë, lani menjëherë me ujë të pastër dhe sapun pjesët e kontaminuara.
- I aksidentuari nuk jep shenja karakteristike. Me pas pacienti dërgohet në një qendër spitalore, ku tregohet etiketa e produktit.
- Andidot specifik nuk ka. Aplikohet terapi simptomatike.

Përdorimi:

Ne perime ne serra dhe fushe (domate,spec, trangull, patellxhan etj): Për kontrollin e afideve, me 0.02-0.03 %, krahebardhave, tripseve dhe liromizes, me 0.05-0.06%,

Ne peme frutore: Për kontrollin e afideve, me 0.025%, psillave në dardhe, krimbit të molles, minueseve, morrit të përgjakshëm, lepidoptereve dhe mikrolepidoptereve të tjera, me 0.05%.

Ne patate: Kunder buburecit të patates dhe afideve, me 0.02-0.025%

Ne agrume: Për kontrollin e breshkezave pambukore (*Planococcus citri*), (*Icerya Purchasi*), me 0.05 %, minueseve (*Phyllocnistis citrella*), tripsit (*Scirtothrips aurantii*), me 0.04 %, breshkezes së kuqe (*Aonidiella aurantii*), afideve (*Aphis gossypii*, *Toxoptera citricida*), minueses (*Phyllocnistis citrella*), me 0.04 %.

Ne vreshta: Për kontrollin e tenjes së rrushit, me 0.025%.

Ne duhan: Kunder afideve me dozen 0.03-0.04%

Verejtje per perdorimin:

Keshillohet te mos kryen me shume se dy trajtime gjate nje sezoni mbjelljeje per çdo kulture. Perzihet me te gjithë insekticidet me perjashtim me ato me reaksion alkaline. Siguroni nje lagje te plote e te njetrajtshme te siperfaqes gjethore.

Ndikimi ne ekosistem:

Mos e aplikoni ne kohen e levizjes se insekteve pllenues. Mesatarisht helmues ndaj bleteve dhe insekteve te tjera te dobishme. Për të mbrojtur organizmat ujorë afër parcelës që do të trajtohet respektoni një brez sigurie të pa trajtuar me gjerësi prej 5 metrash nga ujrat sipërfaqësore. Eshte helmues ndaj organizmave ujore, prandaj mos ndotni mjediset ujore me kete produkt apo ambalazhet e tij.

Karenca:

7 dite per perimet; 14 dite per agrumet, pataten dhe duhanin; 21 dite per berthamoret; 28 dite per mollen; 50 dite per dardhen.

Magazinimi:

Ruhet ne ambalazh origjinal, ne ambjente te thata e te fresketa, pa ndriçim, te ajrosura dhe te sigurta nga rreziku zjarrit, ne temp. 0-35⁰ C.

Numri dhe data e regjistrimit: 763, datë 28.4.2021.

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: 4-50 gr;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese:_____;

Data e prodhimit:_____;

Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia, Shishe COEX ose HDPE;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Sharda Cropchem Ltd. **Adresa:** Mumbai-Indi.

Emri dhe adresa e aplikantit: Sharda Cropchem España S.L. **Adresa:** Murcia, Spanjë.